



Nr. 271 Prot.

Tiranë, më 07/05 /2024

KALLËZIM PENAL

KALLZUES:

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, subjekt i së drejtës regjistruar me vendimin 12 datë 19/12/1990 të Ministrit të Drejtësisë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Enkelejd Alibeaj, me adresë Rruga Donika Kastrioti, Tiranë.

OBJEKTI:

Kallëzim i veprave penale “Shpërdorim i detyrës” dhe/ose “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 dhe 320 të Kodit Penal.

KUNDËR:

1- **LINDITA NIKOLLA**, e bija e Llesh-it dhe Rute-s, lindur më 22.10.1965, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me kartën e identitetit me numër personal G56022058H, me detyrë Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe adresë për efekt njoftimi Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale,

Neni 81 i ligjit 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Nenet 8, 9, 10 e vijues të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,

Nenet 1, 7, 14, 87 e vijues të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin numër 166, datë 16.12.2004 të Kuvendit

DREJTUAR:

PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR.

I nderuar Drejtues,

Neni 81 i ligjit ligjit 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” përveç përcaktimit lidhur me detyrueshmërinë e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, parashikon ndër të tjera, në pikën 4, edhe hipotezën ligjore se “*Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal*”. Një parashikim i tillë, i përmbajtur në një ligj (i miratuar me 3/5 e votave në Kuvend në të njëjtin rang si edhe Kodi Penal), në vetvete vendos trajtim dhe mbrojtje të njëjtë, në planin penal, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sikurse edhe për vendimet e gjykatave civile, penale dhe administrative. Kjo dispozitë pra vendos një referim të drejtpërdrejt tek mbrojtja që Kodi Penal duhet t’u japë vendimeve gjyqësore.

Duke marrë shkas nga ky rregull ligjor, e duke u bazuar edhe në dispozitat procedurale penale, konkretisht nenet 280 e vijues të KPP, si një shtetas por edhe si një anëtar i Kuvendit, më lind detyrimi ligjor për të paraqitur këtë kallëzim penal (sic parashikohet ndër të tjera edhe në nenin 283/1, fjalía e dytë, e KPP). Për këtë shkak po e paraqes para Jush sipas formës procedurale që akti në fjalë kërkon, të shkruar e të nënshkruar, duke përshkruar në vijim edhe faktin penal, elementët e veprës penale, burimet e elementëve të provave dhe çdo rrethanë tjetër, të cilën e gjykoj të dobishme për procedimin penal eventual që juve do mund të ndërmerrni.

Sic e kam cituar në krye të aktit dhe sic do rezultojë nga përshkrimet e mëposhtme rreth fakteve, rezulton se kompetenca funksionale, qoftë për pranimin e kallëzimit e qoftë për ushtrimin e ndjekjes penale, i takon organit të prokurorisë (SPAK), që Juve drejtoni, pasi dyshimi për kryerjen e veprës/ave penale i kunddrejtohet shtetasës së treguar në krye të këtij kallëzimi (apo edhe shtetasve të tjerë që juve mund t’ju rezultojnë përgjatë hetimit), që ushtron ndër të tjera, funksionin e deputetit dhe të Kryetarit të Kuvendit, e për këtë shkak përfshihet në hipotezën e parashikuar në nenin 75/a të KPP.

Shkas fillestar i këtij kallëzimi, është fakti se Gjykata Kushtetuese, ka emetuar një vendim të saj, me numër 38 datë 09.12.2022. Në dispozitivin e këtij vendimi, në pikat 2 dhe 3, Gjykata ka vendosur:

- 2. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligjor.*
- 3. Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një viti.*

Kështu pra, rezulton se mbi Kuvendin e Shqipërisë, në cilësinë e organit publik (palë ndërgjyqëse në atë gjykim) të ngarkuar drejtpërdrejt me vendimin e Gjykatës Kushtetuese numër 38, datë 09.12.2022, rëndon detyrimi për zbatimin e këtij vendimi, brenda një afati 1 vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të vetë vendimit (dita e fundit e përmbushjes së afatit 1 vjeçar daton më 12.01.2023). Për më shumë, detyrimi konsiston në “plotësimin e boshllëkut ligjor”, pra miratimi i rregullave normative shtesë, të rangut ligj, proces që sipas Kushtetutës është kompetencë ekskluzive e Kuvendit të Shqipërisë. Deri në datën e depozitimit të këtij kallëzimi, në bazë të informacioneve publike, nuk rezulton që Kuvendi i Shqipërisë të ketë përmbushur detyrimin për zbatimin e vendimit të Gjykatës.

Në kushtet pra, të moszbatimit të vendimit numër 38 të Gjykatës Kushtetuese, po Ju parashtrojmë këtë kallëzim penal për veprat penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal dhe/ose “Shpërdorimi i detyrës” të

parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal të cilat vlerësojmë se janë konsumuar nga Kuvendi i Republikës, për shkak se nga organet drejtuese të tij, kryesisht nga Kryetari i Kuvendit, nuk janë krijuar kushtet që Kuvendi, si organ kolegjal të përmbushte këtë detyrim. Kryetari i Kuvendit, sipas parashikimeve kushtetuese (neni 76/1 i Kushtetutës) është autoriteti që “... përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij”. Ky detyrim kushtetues, është i replikuar edhe në aktin rregullator të Kuvendit – Rregullorja e Kuvendit (neni 7/1) – sipas së cilës Kryetari i Kuvendit është organi i cili “...përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij”.

Më poshtë në këtë kallëzim kemi parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike e provat me anë të të cilave vërtetohet dyshimi për konsumim të veprës penale.

RRETHANAT E FAKTIT

1. Nëpërmjet ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor me ligjin nr. 101/2020, të cilat kanë hyrë në fuqi më 19.08.2020, Kuvendi ka synuar realizimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar në zgjedhjet për Kuvendin për zgjedhësit me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësonin kërkesat e nenit 24, pika 1, përmes votimit të tyre edhe nga jashtë vendit.
2. Sipas nenit 24 të Kodit Zgjedhor: “1. KQZ-ja udhëheq dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë vendit dhe kërkojnë nga KQZ-ja që të pajisen me dokumentacionin e votimit nga jashtë. 2. Votimi nga jashtë vendit organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregullatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij ligji. 3. KQZ-ja duhet të marrë vendim për përfshirjen për herë të parë të votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit. 4. Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të KQZ-së.”. Kurse në nenin 184 të këtij kodi parashikohet: “Ngarkohet KQZ-ja të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda gjastë muajve nga hyrja në fuqi e tij.”.
3. Procesi për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që do të mundësonin këtë mënyrë votimi do të bëhej nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e KQZ-së, ndërsa votimi nga jashtë vendit do të organizohej dhe administrohej nga kjo e fundit në të gjithë komponentët e tij, vetëm pasi Komisioni Rregullator të miratonte të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij ligji. Kompetenca për miratimin e akteve nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit, sipas këtij ligji, i është ngarkuar një prej organeve drejtuese të KQZ-së, pikërisht Komisionit Rregullator (neni 24, pika 2, i Kodit Zgjedhor). Në pikën 1 të nenit 20 të Kodit Zgjedhor parashikohet se Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter

normativ, ndër të tjera, edhe rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin (shkronja “dh”). Sipas pikës 2 të kësaj dispozite, Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së, ndër të tjera, edhe për zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, mbështetur në raportimin e Komisionerit për plotësimin e masave tekniko-organizative që mundësojnë votimin. Nga data e hyrjes në fuqi të ligjit 101/2020 e deri në datën e depozitimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nga ana e KQZ nuk u ndërмор asnjë hap procedural për hartimin dhe miratimin e akteve të nevojshme nënligjore për mundësimin e votimit nga jashtë vendit. Në procesin zgjedhor të vitit 2021, votimi i shtetasve shqiptarë me të drejtë vote, me banim jashtë territorit shqiptar (emigrantë), nuk u realizua.

4. Me kërkesën e datës 25.2.2022, shoqata “Diaspora për Shqipërinë e Lirë” i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.4.2021 për shkak të mosveprimit të organeve të ngarkuara nga Kodi Zgjedhor. Në procesin gjyqsor të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese, përfaqesuesit e KQZ paraqitën si mbrojtje në gjykim pretendimin se nuk kishte një parashikim ligjor që vota nga jashtë duhet të mundësohej në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Ky pretendim i KQZ u pranua si i vërtetë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin në fjalë.
5. Gjatë shqyrtimit gjyqsor të çështjes Gjykata Kushtetuese arsyeton se: *“Bazuar në sa më sipër, në vlerësim të Gjykatës, formulimi i nenit 184 të Kodit Zgjedhor nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës, i cili përcakton se aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë dhe se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. Në këtë kuptim, nisur nga fakti se ligjvënësi tashmë ka zgjedhur të pranohet në ligj të drejtën për të votuar të shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në zgjedhjet për Kuvendin, Gjykata çmon se paqartësia e normave të Kodit Zgjedhor në drejtim të afatit, organit kompetent dhe parimeve në bazë të të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore për këtë çështje jo vetëm cenon parimin e sigurisë juridike, por në fakt përbën boshllëk ligjor, që cenon të drejtën kushtetuese të votës. Me fjalë të tjera, e drejta kushtetuese e votës së kësaj kategorie për shkak të boshllëkut ligjor ka mbetur thjesht një parashikim deklarativ, i pazbatueshëm efektivisht në praktikë, duke mbetur në thelbin e saj iluzive”.*
6. Në përfundim të shqyrtimit gjyqsor, Gjykata Kushtetuese me vendimin numër 38, datë 09.12.2022 vendosi:
 1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
 2. **Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligjor.**
 3. **Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një viti.**
 4. Pushimin e gjykimit lidhur me urdhrin nr. 219, datë 19.4.2021 të Ministrisë së Shëndetësisë.*Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.*
7. Vendimi numër 38, datë 09.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese është shpallur më 09.01.2023, por botuar në fletoren zyrtare numër 5 të datës 12 janar 2023 duke bërë që vendimi i sipërcituar të hynte në fuqi pikërisht në të njëjtën datë me botimin e tij. Referuar dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese (3. ***Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligjor brenda një***

viti) rezulton që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kishte detyrimin ligjor që të zbatonte vendimin numër 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese deri në datën 12.01.2024.

8. Me datë 10.03.2023 Kryetarja e Kuvendit rezulton të ketë nxjerrë urdhrin numër 14, me objekt “Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit”. Në këtë urdhër është përcaktuar që në mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit të merret në shqyrtim edhe vendimi numër 38, datë 09.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese. Ky urdhër i shtetases Lindita Nikolla është nxjerrë në zbatim të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit i cili përcakton detyrimin e Kryetarit të Kuvendit të mbledhë Këshillin e Legjislacionit me qëllim shtrimin për vlerësim nga ky i fundit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vecanërisht në respektim të afati 30 ditor për vlerësimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të cilët kanë efekt në legjislacion (neni 87, pikat 2 dhe 5).
9. Këshilli i Legjislacionit nën drejtimin e deputetes Ermonela Felaj, në zbatim të urdhrin numër 14, datë 10.03.2023 të Kryetares së Kuvendit, është mbledhur me datë 15.03.2023. Në këtë mbledhje është vendosur që për secilin nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar në urdhrin 14 të caktohet një relator. Për vendimin numër 38 është caktuar relatore deputetja Etilda Gjonaj. Në përfundim të mbledhjes është vendosur që nga ana e relatores Gjonaj të pregatitet relacioni përkatës për vendimin 38 të Gjykatës Kushtetuese. Në datë 03.04.2023 është rimbledhur Këshilli i Legjislacionit. Në këtë mbledhje janë parashtruar relacionet përkatëse të hartuara nga relatorët. Për vendimin numër 38 të Gjykatës Kushtetuese relacioni i hartuar nga deputetja Gjonaj është parashtruar po nga kjo deputete. Në përfundim të relacionit Këshilli i Legjislacionit ka vendosur që vendimi 38 i Gjykatës Kushtetuese, së bashku me relacionin përkatës të pregatitur nga deputetja Gjonaj t’i përcillej Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore.
10. Nuk rezulton e dokumentuar (as në faqjen e internetit të Kuvendit) që relacioni, vendimi i Këshillit të Legjislacionit dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese t’i jenë përcjellë për ndjekje dhe zbatim Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore.
11. Bashkëkryetari i Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore Enkelejd Alibeaj, edhe në cilësinë e deputetit dhe përfaqësuesit të Partisë Demokratike në Komision, me datë 15 nëntor 2023, në dritën edhe të detyrimit ligjor për zbatimin e vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese, ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”. Në këtë projektligj është hartuar në formën e ndryshimeve ligjore edhe plotësimi i boshllëkut ligjor të evidentuar nga vendimi numër 38 i Gjykatës Kushtetuese. Ky projektligj ndonëse është depozituar në rrugën e zakonshme për depozitimin e projektligjeve ende, deri në ditën e depozitimit të këtij kallzimi, nuk është bërë pjesë e kalendarit të punimeve të Komisioneve të Përhershme apo seancës plenare të Kuvendit, pra nuk është futur në proces legjislativ. Gjithashtu rezulton se me datë 11 dhjetor 2023 në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar edhe një projektligj tjetër “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, që adreson zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, i cili edhe ai, nuk është përfshirë në kalendarin e punimeve të Komisioneve të përhershme apo seancën plenare të Kuvendit.
12. Vendimi numër 38 i Gjykatës Kushtetuese në pjesën urdhëruese të tij (sikurse kemi cituar edhe më lartë) përcakton se afati brenda të cilit Kuvendi duhet të zbatojë vendimin dhe të plotësojë boshllëqet ligjore është 1 vit nga data e hyrjes në fuqi të tij. Në zbatim të kësaj pike të pjesës urdhëruese të vendimit rezulton se afati përfundimtar brenda të cilit Kuvendi do të duhet të kishte zbatuar vendimi është data 12 janar 2024. E kuptueshme është se nëse deri në

datën 12 janar 2024 jemi në kushtet e pengimit të zbatimit të vendimit të gjykatës, me kalimin e datës 12 janar jemi në kushtet e moszbatimit të vendimit të gjykatës, e për pasojë në kushtet e parashikuara nga pika 4 e nenit 81 të ligjit 8577/2000 për përgjegjësinë penale në rastin e moszbatimit të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese.

ARSYETIMI LIGJOR

13. Duke respektuar të drejtën ligjore të organit të akuzës për cilësimin e saktë ligjor të veprës penale vlerësojmë se në objekt kallzimi janë konsumuar plotësisht elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe/ose “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” parashikuar përkatësisht nga nenet 248 dhe 320 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.
14. Vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikohet në nenin 248 të Kodit Penal i cili përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.*
15. Vepra penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” parashikohet në nenin 320 të Kodit Penal i cili përcakton se: *“Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.*
16. Neni 81 i ligjit 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” përcakton se: *“1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. 2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore. 3. Gjykata Kushtetuese, në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit. 4. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.”.*
17. Nga analiza e dispozitivit (pjesës urdhëruese) të vendimit numër 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese rezulton se Gjykata ka ngarkuar Kuvendin me detyrimin për a) plotësimin e boshllëkut ligjor dhe b) përmbushjen e këtij detyrimi brenda afatit një vjeçar nga botimi i vendimit në fletoren zyrtare. Kjo pjesë urdhëruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese është në zbatim të plotë të pikave 1 dhe 3 të nenit 81 të ligjit 8577/2000. Pika 3 e nenit 81 i jep kompetencën Gjykatës Kushtetuese që nëpërmjet dispozitivit (pjesës urdhëruese) të vendimit të përcaktojë organin publik (në rastin konkret Kuvendin) që ka detyrimin për zbatimin e vendimit dhe njëkohësisht të përcaktojë edhe afatin kohor brenda të cilit vendimi do të duhet të zbatohet.
18. Nga analiza harmonike e nenit 81 të ligjit 8577/2000 dhe vendimit 38/2022 të Gjykatës Kushtetuese rezulton se a) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë kishte për detyrë të zbatonte vendimin e Gjykatës Kushtetuese duke plotësuar boshllëkun ligjor brenda një viti nga hyrja në

fuqi e vendimit b) ky detyrim për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese duhej të përmbushej nga Kuvendi brenda datës 12.01.2024 (bazuar në faktin që vendimi është botuar në fletoren zyrtare numër 5, të datës 12.01.2023 dhe hynte në fuqi me botimin e tij në fletoren zyrtare) dhe c) përgjegjësia penale për moszbatimin ose pengimin e zbatimit të vendimit 38/2022 të Gjykatës Kushtetuese është e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë si organi i ngarkuar nga vetë Gjykata për zbatimin e tij.

19. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë si një organ kolegjal, rregullon veprimtarinë e vet, pra organizimin dhe funksionimin me anë të Rregullores së tij. Ky është një parashikim i përmbajtur në nenin 75/2 të Kushtetutës. Rregullorja e Kuvendit është miratuar me vendimin numër nr. 166, datë 16.12.2004, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, vendimin nr. 193, datë 7.7.2008, vendimin nr. 21, datë 04.03.2010, vendimin nr. 41, datë 24.6.2010, vendimin nr. 88, datë 24.2.2011, vendimin nr. 41 datë 30.05.2013, vendimin nr. 95 datë 27.11.2014, vendimin nr. 88 datë 14.9.2017, vendimin nr. 85 datë 18.7.2019, vendimin nr. 12/2020, vendimin nr. 86/2021 dhe vendimin nr. 126/2023.
20. Kjo rregullore në nenin a/1, pika 1, parashikon fushën e zbatimit të saj duke përcaktuar se: *“1. Kjo Rregullore përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në vijim Kuvendi, për organet drejtuese, mbledhjet e komisioneve dhe seancave plenare, procedurën ligjvënëse, kontrollin parlamentar, monitorimin e procesit për integrimin europian, zgjedhjen/ emërimin/ shkarkimin e organeve kushtetuese dhe të institucioneve të krijuara me ligj, interpretimin dhe ndryshimin e Rregullores, imunitetin parlamentar, transparencën dhe shërbimet e Kuvendit”*. Nisur nga fusha e zbatimit të Rregullores, në nenin 7/1 të saj është përcaktuar edhe funksioni dhe detyrat e Kryetarit të Kuvendit. Në mënyrë të përmbledhur neni 7/1 i Rregullores përcakton se: *“1. Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij... 6. Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij, Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime.”*
21. Në raport me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Kuvendit ka parashikuar në nenin 87 të saj një procedurë të detajuar veprimi. Neni 87 i Rregullores përcakton se: *“Neni 87 - Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese - 1. Kryetari i Kuvendit i përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e Gjykatës Kushtetuese për: a) vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtar deputetin/deputetët; b) interpretimin përfundimtar të Kushtetutës; c) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës kur Kuvendi është palë; ç) shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët zgjidhen nga Kuvendi; d) rastet kur kërkesa në Gjykatë Kushtetuese është paraqitur nga jo më pak se 1/5 e deputetëve. 2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, që kanë efekt në legjislacion, merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin brenda 30 ditëve pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare. 3. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për çështjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli harton një raport dhe ia paraqet atë Kryetarit të Kuvendit. 4. Raporti i Këshillit, kur çmohet e nevojshme, mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës. 5. Kur nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmerr vetë nismën ligjvënëse”*.

22. Duke analizuar në harmoni me njëra tjetrën dispozitat e ndryshme të Rregullores së Kuvendit arrihet në përfundimin se Kryetari i Kuvendit përveçse është përgjegjës zhvillimin e veprimtarisë parlamentare në përgjithësi, ka detyrimin që, në rastin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të përcjellë në Këshillin për Legjislacionin të gjitha vendimet e Gjykatës të cilat i janë ngarkuar për zbatim, apo që prekin fushën e punës së Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit përcakton se vendimet e Gjykatës Kushtetuese të cilat kanë efekt në legjislacion duhet të merren në shqyrtim nga Këshilli i Legjislacionit brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e tyre. Në rastin e vendimit numër 38 të Gjykatës Kushtetuese, rezultoi se ky i fundit ka hyrë në fuqi me datë 12 janar 2023 ndërkohë që urdhri numër 14 i Kryetares së Kuvendit, për shqyrtimin e këtij vendimi nga Këshilli i Legjislacionit, është nxjerrë me datë 10 mars 2023, afro 60 ditë pas hyrjes në fuqi të vendimit. Ky veprim në vonesë i Kryetares së Kuvendit ka sjellë si pasojë shkeljen e detyrimit të Kuvendit për shqyrtimin e vendimit brenda afatit 30 ditor duke përmbushur kushtet formale për konsumimin e elementëve të veprave penale **“Shpërdorimi i detyrës”** dhe/ose **“Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”** të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 dhe 320 të Kodit Penal.
23. Në raport me anën objektive të veprës penale **“Shpërdorimi i detyrës”** rezultoi se shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit, kishte detyrimin që të bënte të mundur që brenda afatit 30 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli i Legjislacionit të merrte në shqyrtim vendimin 38 të Gjykatës Kushtetuese. Rregullorja e Kuvendit parashikon që Kryetari i Kuvendit është personi përgjegjës për mbarëvajtjen dhe punën dhe funksionimin të brendshëm të Kuvendit. Referuar pikës 1 të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit rezultoi se procedura për shqyrtimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të fillojë pa kryerjen e veprimeve administrative për thirrjen e Këshillit të Legjislacionit nga Kryetari i Kuvendit. Pikërisht në zbatim të pikave 1 dhe 2 me datë 10 mars 2023 Kryetarja e Kuvendit ka vënë në lëvizje Këshillin e Legjislacionit, pamvarësisht se ndërkohë nga ana e saj ishin konsumuar elementët e veprës penale. Vendimi 38 i Gjykatës Kushtetuese në pjesën urdhëruese të tij përcaktoi se ky vendim hyn në fuqi me publikimin e tij në Fletoren Zyrtare, ç’ka do të thotë që vendimi, edhe për Kuvendin, ka hyrë në fuqi me datë 12 janar 2023. Pikërisht nga data 12 janar fillon afati 30 ditor brenda të cilit Këshilli i Legjislacionit, i mbledhur me urdhër të Kryetares së Kuvendit, duhet të kishte marrë në shqyrtim këtë vendim. Nuk ka asnjë shkak ligjor për të cilin shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit, përlligjet në veprimet e saj për mosdërgimin brenda afatit të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim në Këshillin e Legjislacionit. Neni 248 i Kodit Penal konsideron se shkak të mjaftueshëm për konsumimin e veprës penale **“Shpërdorimi i detyrës”** mospërmbushjen e rregullt të detyrës, me kusht që kjo mospërmbushje të ketë sjellë si pasojë cënimin e interesave të ligjshëm të shtetasve. Në rastin objekt kalëzimi jemi në kushtet kur mosveprimet e shtetasës Lindita Nikolla, të cilat vijnë në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit (mospërmbushja e rregullt e detyrës) kanë cënuar interesin e palës kërkuese (më së paku), e cila ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese dhe që është edhe përfutjesja e vendimit gjyqsor 38, për plotësimin e boshllëkut ligjor.
24. Në raport me anën objektive të veprës penale **“Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”** rezultoi se që shtetasja Lindita Nikolla me anë të veprimeve (mosveprimeve) ka sjellë si pasojë pengimin e ekzekutimit të një vendimi gjyqsor, në tre episode të ndara nga njëri-tjetri. Së pari, sjellim në vëmendjen Tuaj se pika 4 e nenit 81 të ligjit 8577/2000 përcaktoi se pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal. Ky nen është në të njëjtën linjë logjike me nenin 320 të Kodit Penal. Që të konsumohen elementët e veprës penale të pengimit të ekzekutimit të vendimeve gjyqsore është e mjaftueshme kryerja e veprimeve (mosveprimeve) të cilat kanë sjellë si pasojë

pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqsor. Duke u kthyer në rastin objekt kallzimi, si episod i parë, rezulton se me mosveprimin (dërgimin brenda afatit të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli i Legjislacionit) e saj në periudhën 12.01.2023 – 10.03.2023 shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit ka penguar ekzekutimin e një vendimi gjyqsor, dhe konkretisht të vendimit numër 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

25. Episodi i dytë, ka lidhje me detyrimet që Kryetari i Kuvendit ka (sipas Rregullores) për të avancuar dhe mbështetur procesin legjislativ si zbatim i një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, kur sinjalizohet apo sugjerohet nga vendimmarrja e Këshillit të Legjislacionit. Pika 5 e nenit 87 të Rregullores së Kuvendit parashikon se në rastet kur është i nevojshëm ndryshimi ose plotësimi i legjislacionit (pra kur Gjykata Kushtetuese ka vendosur kështu), Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmerr vetë nismën ligjvënëse. Në rastin objekt kallzimi rezulton se në mbledhjen e datës 03.04.2023 Këshilli i Legjislacionit të ketë vendosur t'i përcjellë Komisionit për Reformën Zgjedhore relacionin përkatës së bashku me rekomandimin për fillimin e procesit legjislativ për plotësimin e boshllëkut ligjor të konstatuar nga Gjykata Kushtetuese. Bazuar në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shërbimeve të Kuvendit, miratuar me vendimin numër 42, datë 16.07.2015 të Byrosë së Kuvendit, rezulton se përcjellja e akteve nga Këshilli i Legjislacionit në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore duhet të ndiqte rrugën e brendshme administrative. Në dijeninë tonë si kallëzues, materiali i sipërcituar dokumentar nuk është përcjellë administrativisht tek bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, fakt i cili provohet edhe nga drafti fillestar i kalendarit të punimeve të Komisionit i cili nuk përfshin në rendin e punimeve, ndryshimet ligjore të detyrueshme, në zbatim të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese. Këto ndryshime janë përfshirë në kalendarin e miratuar të punimeve vetëm me kërkesë e përfaqësuesit të Partisë Demokratike, por jo si një kërkesë e rrjedhur nga veprimtaria e brendshme administrative e vetë Kuvendit me kërkesë të Kryetares së Kuvendit. Fakti që në hartimin e draft kalendarit të punimeve nuk është përfshirë plotësimi i boshllëkut ligjor të konstatuar nga Gjykata Kushtetuese tregon që nga ana e Kuvendit nuk është përcjellë për dijeni bashkëkryetarëve të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore relacioni dhe vendimmarrja e Këshillit të Legjislacionit të datës 03.04.2023. Këto veprime të Kuvendit, të drejtuar nga shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së tij, janë veprime që përbëjnë nga njëra anë mospërbushje të rregullt të detyrës dhe nga ana tjetër veprime që pengojnë zbatimin e një vendimi gjyqsor. Nisur nga sa analizuar më sipër rezulton se shtetasja Lindita Nikolla ka konsumuar tërësisht elementët e veprëve penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe/ose “Pengimet për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” të parashikuara nga nenet 248 dhe 320 të Kodit Penal.

26. Episodi i tretë është edhe më flagrant. Më datë 15 nëntor 2023 nga ana e deputetit Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e deputetit është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë (me shkresën numër 3523 prot.) projektligji “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 10019, datë 29. 12.2018 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ky projektligj në brendësi të tij parashikon edhe ndryshimet dhe plotësimin e boshllëkut ligjor të konstatuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin numër 38 të saj. Në shkresën numër 3523 prot. me të cilën është pranuar depozitimi i projektligjit nga administrata e Kuvendit, gjendet shënimi “Seancë plenare” i cili në parim përcakton rrugën administrative që duhet të ndjekë akti deri në shqyrtimin e tij nga Seanca Plenare e Kuvendit. Praktika parlamentare përcakton se nismat ligjore futen në kalendarin e punimeve të Kuvendit, kalendar i cili miratohet nga Konferenca e Kryetarëve, me propozim të Kryetarit të Kuvendit. Në rastin konkret, shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e përfaqësueses dhe administrueses së veprimtarisë së Kuvendit, kishte

detyrimin dhe mundësinë juridike për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që ky organ të përmbushte detyrimin që i ishte ngarkuar nga vendimi 38 i Gjykatës Kushtetuese. Detyrimi kryesor i saj ishte të ndërmernte hapat e nevojshëm administrative, nëpërmjet të cilave të garantohej që nisma ligjore të kryente *iteri*-n e domosdoshëm legjislativo-parlamentar dhe të paraqitej për diskutim në seancë plenare përpara përfundimit të afati 1 vjeçar të parashikuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Në kundërshtim me këtë detyrim, pavarësisht pasjes së të gjitha tagrave që Rregullorja e Kuvendit i njehe Kryetarit për përfshirjen në kalendarin e punimeve të nismave ligjore që kishin për synim plotësimin e boshllëkut ligjor të evidentuar dhe lënë si detyrë nga Gjykata Kushtetuese, shtetasja Lindita Nikolla nuk e ka përfshirë projektligjin në kalendarin e punimeve të Kuvendit, nuk e ka përcjellë projektligjin për shqyrtim në Komisionet e nevojshme parlamentare e për pasojë ka kufizuar/penguar në mënyrë përfundimtare cdo mundësi që projektligji të kalonte në fazat pasuese të procesit derisa të mbërrinte në fazën finale që është shqyrtimi në seancë plenare (faza e votimit është në dorë të votës individuale të secilit deputet). Me shqyrtimin eventual në komisionet parlamentare, e më pas me përfshirjen në rendin e ditës së seancës plenare e më pas me shqyrtimin në seancë plenare, do të ishte ezauruar një segment i detyrueshëm i procesit ligjvënës para miratimit të tij. Kjo është një fazë e domosdoshme, që i paraprin, fazës së miratimit të ligjeve (votimit në seancë plenare). Pa u ezauruar kjo fazë paraprake, vetë Kuvendi si një trup kolegjial që vepron në formacion të plotë në seancë plenare, ndodhet në pamundësi objektive të miratojë eventalisht rregulla ligjore, që të plotësonin boshllëkun ligjor që ka konstatuar Gjykata Kushtetuese. Vetëm kështu do të mund të përmbushej detyrimi për zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese (fazat e tjera të procesit legjislativ, shpallja dhe botimi në Fletoren Zyrtare janë faza vijuese që përplotësojnë procesin e miratimit të ligjit por nuk varen nga Kuvendi). Kryetarja e Kuvendit, nuk ka patur asnjë pengesë të ligjshme, që me kompetencat që ka, përgjatë procesit të ligjvënës, të shtynte procesin, drejt zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Është kryetarja e Kuvendit, që ka kompetencë për ta futur në proces ligjvënës një projektligj, së pari duke e futur në rendin e ditës së konferencës së kryetarve, duke propozuar se cilat komisione duhet ta shqyrtojnë dhe brenda cilit afat, e po ashtu edhe në cilat seanca plenare të ardhshme të mund të planifikohej për shqyrtim. Kryetarja e Kuvendit është edhe drejtuese e administratës së Kuvendit, me anë të së cilës ka mundësinë të monitorojë shpejtësinë e ecurisë së procesit legjislativ dhe kështu të ndërmernte edhe hapat konkret për zbatimin e vendimit të gjykatës në afat. Është kryetarja e Kuvendit, që vendos edhe rendin e ditës së seancave plenare të Kuvendit. Është kryetarja e Kuvendit që drejton e administron edhe procesin e votimit në seancë. Asnjë nga këto faza të procesit që vihen në lëvizje me kompetencat ekskluzive që Rregullorja ia njehe nuk janë ushtruar nga kryetarja e Kuvendit. Projektligji në fjalë, është depozituar që në datë 15 nëntor 2023, kohë e mjaftueshme kjo, që procesi legjislativ të ezaurohej në mënyrë shteruese, deri në datën finale që ishte data 12.01.2024.

27. Të njëjtën sjellje mosvepruese dhe penguese, ka mbajtur edhe ndaj projektligjit tjetër, i cili adresonte po vendimin e Gjykatës Kushtetuese numër 38. Me datë 11 dhjetor 2023 një grup prej 7 deputetësh kanë nënshkruar dhe depozituar në Kuvend (me shkresën numër 3797 prot) projektligjin “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin nr. 10 019, datë 29. 12.2018 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ky projektligj prek dhe ndryshon Kodin Zgjedhor vetëm në raport me boshllëkun e evidentuar nga vendimi numër 38 i Gjykatës Kushtetuese lidhur me votën e diasporës. Sikurse referuar më lartë në raport me praktikën parlamentare, respektimi i saj kërkon që edhe për këtë projektligj nga ana e Kuvendit të ndërmerreshin hapat administrative duke realizuar ose përcjelljen e tij në Komisionin e Posaçëm të Reforëms Zgjedhore, ose përfshirjen e tij në kalendarin e punimeve të Kuvendit. Edhe në rastin e këtij projektligji rezulton se nga ana e shtetasës Lindita Nikolla, në cilësinë e

Kryetares së Kuvendit të mos jenë kryer veprimet e parashikuara duke konsumuar njëkohësisht elementët e mospërbushjes së rregullt të detyrës publike dhe/ose pengimin e zbatimit të vendimit të gjykatës. Edhe për këtë projektligj nuk është ndjekur asnjë nga hapat e nevojshëm të *iter*-it legjislativ.

28. Veprimet e përsëritura të shtetasës Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit për të penguar, kufizuar dhe vonuar procesin e brendshëm parlamentar të shqyrtimit të projektligjeve që kishin për objekt plotësimin e boshllëkut ligjor të konstatuar dhe të lënë si detyrë nga Gjykata Kushtetuese, përbëjnë pengim të zbatimit të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në faktin që këto veprime janë të shtrira në kohë e vijnë të përsëriten (me mospërfshirje në kalendarin e punimeve të Kuvendit) deri në ditën e depozitimit të këtij kallzimi, arrijmë në përfundimin se jemi në kushtet e **veprës penale vazhduese**. Doktrina juridike njeh si vepër penale vazhduese rastin kur vepra penale përbëhet nga dy ose me shumë veprime homogjene, të kryera në kohë të ndryshme, por në raste të ngjashme, që cenojnë të njëjtën normë ligjore ose norma të të njëjtit lloj e natyrë ose të ngjashme. Në rastin objekt kallëzimi rezulton se veprimet e shtetasës Lindita Nikolla në cilësinë e Kryetares së Kuvendit janë të shumta në numër (nga pengimi nëpërmjet mosthirrjes në kohë të mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit deri tek mos përfshirja në kalendarin e punimeve të projektligjeve dhe hallkat e tjera të zinxhirit legjislativ), janë të kryera në kohë të ndryshme si dhe pengojnë e nuk zbatojnë të njëjtin vendim të Gjykatës Kushtetuese.

29. Gjykata Kushtetuese në pjesën urdhëruese të vendimit ka caktuar një afat një vjeçar për plotësimin e boshllëkut ligjor në raport me votën e shtetasve shqiptare me banim jashtë shqipërisë (diasporës). Plotësimi i këtij boshllëku ligjor i është ngarkuar Kuvendit të Shqipërisë si institucioni ligjvënës në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në nenin 7, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, ky institucion përfaqësohet nga Kryetari i Kuvendit, i cili ushtron për efekt të ligjit dhe rregullores funksionet dhe detyrat e titullarit apo drejtuesit të personit juridik. Nën këtë optikë organi i prokurorisë, mund të marrë parasysh edhe parashikimet ligjore të ligjit 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridike”. Nëse organi i prokurorisë vlerëson se sipas nenit 2 të këtij ligji, Kuvendi konsiderohet si person juridik dhe si i tillë, bie në fushën e zbatimit të këtij ligji, atëherë duhet patur parasysh edhe shkronja c) e nenit 3, që parashikon se një nga rastet kur personat juridikë mund të merren nën përgjegjësi penale është kur rezulton që në emër të tyre të jenë kryer vepra penale, për shkak të mungesës së kontrollit apo të mbikqyrjes nga personi që drejton, përfaqëson apo administron personin juridik. Në rastin objekt kallëzimi jemi në kushtet kur shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e personit që drejton, përfaqëson dhe administron personin juridik Kuvendi i Shqipërisë, me veprimet e saj të mospërbushjes së rregullt të detyrës ka sjellë si pasojë moszbatimin e vendimit numër 38 të Gjykatës Kushtetuese. Dëshirojmë të theksojmë faktin se vendimi 38 i Gjykatës Kushtetuese përcaktonte detyrimin e Kuvendit si subjekt juridik për zbatimin e vendimit, brenda afatit të përcaktuar. Në këtë kontekst është detyrim i personit që përfaqëson, drejton dhe administron subjektin juridik që të ndërmarrë cdo veprim të mundshëm dhe të nevojshëm për zbatimin e vendimit të gjykatës. Duke filluar nga data 12 janar 2023, datë në të cilën është publikuar dhe ka hyrë në fuqi vendimi numër 38 i Gjykatës Kushtetuese, ishte detyrë e shtetasës Lindita Nikolla në cilësinë e Kryetares së Kuvendit që të garantonte që ky vendim do të zbatohet brenda afatit 1 vjeçar të përcaktuar në të. Në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, rezulton se nga ana e shtetasës se sipërpërmendur janë kryer në vijimësi veprime të cilat jo vetëm e kanë penguar zbatimin e këtij vendimi por që në përfundim kanë passjellë edhe moszbatimin përfundimtar të tij brenda afatit të përcaktuar kohor.

30. Nga sa analizuar dhe parashtruar më lartë rezulton se shtetasja Lindita Nikolla në cilësinë e Kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ka shpërdoruar detyrën dhe/ose ka penguar zbatimin e vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese. Sigurisht cilësimin e plotë dhe përfundimtar të veprës penale do ta bëjë organi i prokurorisë në përfundim të veprimtarisë procedurale hetimore.

31. Në mënyrë të përmbledhur konsumimi i elementëve të veprave penale ka ardhur:

- Në periudhën 12 janar 2023 – 10 mars 2023 nëpërmjet mosthirrjes së mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, veprim i cili përbën mospërbushje të rregullt të detyrës dhe ka sjellë si pasojë pengimin e zbatimit të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese.
- Në periudhën 03 prill 2023 – 15 nëntor 2023 nëpërmjet mospërcjelljes së relacionit dhe vendimit të Këshillit të Legjislacionit në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, në kundërshtim me nenet 7 e vijues të Rregullores së Kuvendit, veprim i cili përbën mospërbushje të rregullt të detyrës dhe ka sjellë si pasojë pengimin e zbatimit të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese.
- Në periudhën 16 nëntor 2023 – 12 janar 2024 nëpërmjet mospërfshirjes në punimet e Kuvendit të projektligjeve të depozituara me shkresat numër 3523 prot, datë 15.11.2023 dhe numër 3797 prot, datë 11.12.2023 veprim i cili përbën mospërbushje të rregullt të detyrës dhe ka sjellë si pasojë pengimin e zbatimit dhe moszbatimin përfundimtar të vendimit 38 të Gjykatës Kushtetuese.
- Veprimet e mësipërme kanë çënuar interesin e palës kërkuese (Shoqata “Diaspora për Shqipërinë e lirë”) në vendimin numër 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese, interesin e të gjithë shtetasve shqiptare të cilët janë rezidentë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe kanë penguar dhe pamundësuar zbatimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.
- Veprimet e mësipërme janë kryer me dashje dhe me qëllim pengimin e punës së Kuvendit të Shqipërisë për plotësimin e boshllëkut ligjor të evidentuar nga Gjykata Kushtetuese dhe moskrijimin e kushteve që shtetasit shqiptare rezidentë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të ushtrojnë të drejtën e votës të parashikuar nga Kushtetuta dhe nga interpretimi përfundimtar i saj nëpërmjet vendimit numër 38 të Gjykatës Kushtetuese.

KONKLUZIONE

32. Në përfundim vlerësojmë se nga ana e shtetasës Lindita Nikolla janë konsumuar plotësisht elementët e veprave penale “Shpërdorim i detyrës” dhe/ose “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 dhe 320 të Kodit Penal.

33. Për të mbështetur arsyetimet e parashtruara në këtë kallëzim po ju bashkëlidhim provat si më poshtë vijon:

- Shkresë numër 886, datë 10.03.2023 me lëndë “Urdhër numër 14, datë 10.03.2023 për thirrjen e mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit”;

- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit datë 15.03.2023;
- Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit datë 03.04.2023;
- Shkresë numër 3523 prot, datë 15.11.2023 për depozitim projektligji;
- Shkresë numër 3797 prot, datë 11.12.2023 për depozitim projektligji;

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga

Enkelejd Alibeaj

